



Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

**PROCEDURAT PËRGATITORE NË RASTET CIVILE
KONTESTIMORE**

Edicioni 4

Qershor 2010

Procedurat përgatitore në rastet civile kontestimore

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është e brengosur se dështimi i gjykatave në Kosovë për ti zhvilluar siç duhet procedurat përgatitore në rastet civile kontestimore, shkel kornizën ligjore të Kosovës dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. OSBE ka vërejtur se, edhe pse të obliguara sipas kornizës ligjore në Kosovë, në procedurat civile kontestimore, gjykatat shpesh nuk ja dërgojnë të paditurit kopjen e padisë për përgjigje, para mbajtjes së seancës së parë. Në raste tjera, gjykatat nuk përdorin si duhet procedurat përgatitore për t'i siguruar të gjitha kushtet e domosdoshme për mbajtjen e seancës. Ndonjëherë, gjykatat mbajnë seanca përgatitore madje edhe kur kushtet për të mbajtur këto seanca nuk përmbushen. Këto dështime të gjykatave për të menaxhuar në mënyrë aktive procedurat civile kontestimore mund të ndikojnë negativisht në mbrojtjen e të drejtës të parapara në të drejtën për gjykim korrekt, përfshirë këtu edhe të drejtën për gjykim bazuar në parimin e kundërshtimit dhe të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Veç kësaj, zhvillimi siç duhet i procedurave përgatitore kontribuon në menaxhim më efikas të gjykimit, harxhim më të vogël të resurseve edhe ashtu të mbingarkuara të gjyqësisë në Kosovë, dhe shmangie të vonesave të panevojshme.¹

Ligji i aplikuar mbi procedurën kontestimore² parasheh udhëzues të qartë lidhur me hapat që gjykatat duhen të marrin pas pranimit të padisë. Së pari, gjykata ia dërgon të paditurit³ për përgjigje padinë me shkresat e bashkangjitura, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur është paraqitur në gjykatë.⁴ I padituri më pas ka 15 ditë nga koha kur padia dhe të gjitha dokumentet zyrtare janë parashtruar, që të përgjigjet me shkrim.⁵ Gjykata është po ashtu e obliguar që sa i përket dërgimit të ftesës dhe padisë, të informojë të paditurin për afatin që ka për tu përgjigjur në padi dhe pasojat po që se ky afat tejkalohet.⁶ Në përgjigje ndaj padisë, i padituri duhet të

¹ Komiteti i Ministrave nga Këshilli i Evropës ka deklaruar se “[n]ormalisht, procedurat duhet të përbëhen nga jo më shumë se dy dëgjime, e para nga të cilat mund të jetë një dëgjim preliminar i natyrës përgatitore dhe e dyta për marrjen e dëshmimeve, dëgjimin e argumenteve dhe, mundësisht, shpalljen e aktgjykimin. Gjykata duhet të sigurojë që të gjithë hapat e nevojshëm për dëgjim të dytë të merren në kohë të duhur dhe në parim asnjë shtyrje nuk duhet të lejohet, përpos kur paraqiten fakte të reja apo në rrethana tjera të rëndësishëm dhe të jashtëzakonshme.” Parimi 1, Rekomandimi Nr. R(84)5E i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi *Parimet e Procedurës Civile të Projektuara për të Përmirësuar Funkcionimin e Gjyqësisë*, e miratuar nga Komiteti i Ministrave me 28 shkurt 1984 në takimin e 367-të të Zëvendës Ministrave.

² Ligji Nr.03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Kosovës, 20 shtator 2008 (ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008), të cilin gjykatat në Kosovë kanë filluar ta zbatojnë me 6 tetor 2008. Shih po ashtu Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë 4/1977, 36/1980 dhe 66/1982 të 12 shkurtit 1982 me amendamentet e vitit 1998 (ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 1982). Shumë dispozita të ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 2008 mbesin përmbytësish të ngjashme me ato të ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982.

³ Përkthimi në anglisht i ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 2008, gabimisht përkthen termin nga shqipja “i padituri” si “i akuzuari”.

⁴ Neni 394, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008. Gjykata njëkohësisht “inicion përgatitjet për shqyrtimin kryesor” sapo të pranojë padinë (Neni 386). Shih Nenet 386-393 për hapat tjerë që gjykata duhet të merr në përgatitje për shqyrtimin kryesor.

⁵ Neni 395(1), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

⁶ Neni 395(2), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008. Kur gjykata ja dërgon padinë të paditurit, është e obliguar që ta informojë atë lidhur me përmbajtjen që do të parashtrohet në përgjigje ndaj padisë, si dhe lidhur me pasojat procedurale të dështimit për të parashtruar përgjigjen ndaj padisë. Shih po ashtu Nenin 123(4) të ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 2008: “[g]jykata posaçërisht, me anë të letërthirrjes, i paralajmëron palët dhe pjesëmarrësit e tjerë për

parashtrojë “prapësimet procedurale eventuale,” përgjigjen e tij apo të saj ndaj padisë (pranimin ose refuzimin), dhe të dhënat personale.⁷ Përgjigja e të paditurit, nëse ai apo ajo konteston padinë, duhet që më tej të “përmbajë faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”⁸

Pa marr parasysh se në çfarë dispozite procedurale gjykata akordon padinë pas parashtrimit të saj, ajo duhet gjithmonë t’ia dërgojë padinë të paditurit, para se ky i fundit të paraqitet në çfarëdo lloj seance. Megjithatë, OSBE është e brengosur se gjykatat në Kosovë ndonjëherë mund të dështojnë që në mënyrë adekuate të mbrojnë të drejtën e palës në gjykim bazuar në parimin e kundërshtimit, kur mundësia për të parë padinë në procedurat civile kontestimore nuk ofrohet para seancës së parë gjyqësore. Rasti më poshtë shërben si shembull:

Me 9 shkurt 2010, një nga gjykatat e qarkut në Kosovë mbajti një seancë pajtimi në një rast të shpërbërjes së martesës.⁹ Të dyja palët ishin ftuar në mënyrë të rregullt dhe të dyja morën pjesë në seancën e pajtimit. Seanca e pajtimit u përcoll menjëherë me shqyrtimin kryesor (përshirë edhe procedurën e provave) dhe lëshimin e aktvendimit, të gjitha në të njëjtën seancë. Kopja e padisë nuk ju kishte dërguar të paditurit deri në fillim të seancës së pajtimit, dhe nuk ju kishte ofruar informatë lidhur me të drejtën, apo procedurën, për të parashtruar përgjigje ndaj padisë.¹⁰

E drejta për gjykim bazuar në parimin e kundërshtimit del drejtpërdrejtë nga e drejta për gjykim korrekt e garantuar me Nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). “Parimisht nënkupton mundësinë e palëve në gjykim penal apo civil të kenë njohuri për, dhe të komentojnë mbi të gjitha dëshmitë e administruara apo vërejtjet e parashtruara [. . .] me qëllim të ndikimit në vendim të gjykatës”.¹¹ Ajo që materiali mund të jetë në dosje të gjykatës, në dispozicion të palës nuk përmban mbrojtje të mjaftueshme të së drejtës për gjykim bazuar në parimin e kundërshtimit.¹² Në vend të kësaj, i takon gjykatës që ta informojë të paditurin e lëndës lidhur me

pasojat ligjore për mosardhje në seancë.” Veç kësaj, nëse “palët, ndërhyrësit, përfaqësuesit ligjorë ose përfaqësuesit e autorizuar vazhdimisht i shpërfillin urdhrat e gjykatës, dështojnë të ofrojnë informacion sipas mandatit në këtë ose në ndonjë ligj tjetër në fuqi, ose dështojnë të paraqiten në seancat e caktuara, me qëllim që ta vonojnë procedimin e lëndës, gjykata mund të urdhërojë gjoba në të holla ose të zbatojë masa të tjera të përcaktuara me ligj.” Neni 10(3), *id*

⁷ Neni 396(1), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008. Shih Nenin 99(2), *id.*: “Parashtruesat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit.”

⁸ Neni 396(2), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

⁹ Shih Nenet 76-83 të Ligjit Nr. 2004/32, Ligji mbi Familjen i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2006/7 të 16 shkurtit 2006 (Ligji mbi Familjen). Sipas Nenet 349 të Ligjit mbi Familjen, ligji mbi procedurën kontestimore zbatohet në paditë martesore apo kontestet gjyqësore të ndërmjet anëtarëve të familjes, përpos në rastet kur vet Ligji mbi Familjen parasheh ndryshe.

¹⁰ Disa zyrtarë të gjykatave kanë informuar monitoruesit e OSBE-së se në disa rajone nuk është praktikë e gjykatës në rastet e shpërbërjes së martesës të ja dërgojnë padinë palës kundërshtare para seancës së pajtimit, apo të ja bashkëngjisin fletëthirrjes për këtë seancë.

¹¹ *Vermeulen kundër Belgjikës*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDN), Aktgjykimi i 22 janarit 1996, paragrafi 33.

¹² *Göç kundër Turqisë*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 11 korrikut 2002, paragrafi 57.

materialin dhe të drejtën e atij apo asaj për të komentuar.¹³ Palëve duhet ti ofrohet informacion i mjaftueshëm për t'ju mundësuar të marrin pjesë siç duhet në procedurë.¹⁴

Pasi që i padituri ta ketë parashtruar përgjigjen, barra bie edhe një herë mbi gjykatën për të marr veprim të mëtutjeshëm. Nëse përgjigja është “e pakuptueshme dhe jo e plotë”¹⁵, ose nëse vendos se përgjigja nuk është e mjaftueshme ose është e paqartë¹⁶, gjykata mund të kërkoj nga pala që të bëjë korrigjimet.¹⁷ Nëse, pas marrjes së përgjigjes, gjykata konstaton se “ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot” atëherë, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të merr vendim që ta pranojë padinë si të bazuar.¹⁸ Gjykata fillon seancën përgatitore pasi të ketë pranuar përgjigjen ndaj padisë.¹⁹ Nëse i padituri nuk parashtron një përgjigje dhe gjykata nuk dëshiron ta detyrojë atë, atëherë gjykata nis seancën përgatitore pasi të ketë skaduar afati për parashtrimin e përgjigjes.²⁰ Gjykata duhet të caktojë seancën përgatitore pas konsultimit me palë, po që se është e mundur.²¹ “Si rregull”, seanca duhet të mbahet brenda 30 ditëve pas marrjes së përgjigjes.²²

Seanca përgatitore është e obligueshme, përveç në rastet kur gjykata e vlerëson jo-kontestuese pasi të ketë pranuar përgjigjen nga i padituri, ose në rastet kur gjykata konstaton se nuk është e nevojshme për shkak se rasti “nuk është i komplikuar.”²³ Veç kësaj, nëse i padituri dështon të parashtrtojë një përgjigje ndaj padisë brenda afatit të përcaktuar me ligj, gjykata mund të lëshojë një formë të aktgjykimit të quajtur “aktgjykim për shkak të mos-bindjes”²⁴ Nëse i padituri nuk jep përgjigje në padi, dhe kushtet për lëshimin e aktgjykimit nuk përmbushen, gjykata duhet të filloj seancën përgatitore pasi që të skadojë afati për përgjigjen në padi.²⁵ Në rastet kur padia i dërgohet të paditurit së bashku me fletëthirrjen për seancë përgatitore (në vend se ta bëjë këtë para caktimit të seancës përgatitore) dhe i padituri nuk paraqitet në

¹³ *Id.*

¹⁴ *H.A.L. kundër Finlandës*, GJEDNJ, Aktgjykimi 7 korrikut 2004, paragrafi 51.

¹⁵ Neni 102(1), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

¹⁶ Neni 397, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008. (Sqarim nga përkthyesi: ligji në versionin në gjuhën shqipe edhe këtu përdor termin “e pakuptueshme dhe jo e plotë”).

¹⁷ Neni 397, që i referohet Nenit 102, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

¹⁸ Neni 398, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

¹⁹ Neni 400(1), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

²⁰ Neni 400(2), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

²¹ Neni 400(3), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

²² Neni 400(4), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008. Ngjashëm, dëgjimi kryesor duhet të mbahet brenda 30 ditëve nga përfundimi i seancës përgatitore. Neni 420(2), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

²³ Neni 401, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

²⁴ “Aktgjykimi për shkak mos-bindjes/mungesës” definohet si “[a]ktgjykim i shpallur kundër të pandehurit i cili ka dështuar të deklarohet apo në ndonjë tjetër mënyrë mbrohet ndaj padisë të parashtruar nga paditësi.” Fjalori i Terminologjisë Ligjore, “*Black’s Law Dictionary*”, edicioni i 8të (Shtetet e Bashkuara, Thomson West, 2004), faqe 449. Gjykata mund të shpall aktgjykimin për shkak të mos-bindjes nëse: (a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; (b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; (c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht. Shih Nenin 150(1)(a)-(c), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

²⁵ Neni 400(2), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

seancën përgatitore, gjykata mundet, nën rrethana të caktuara të lëshojë një formë tjetër të aktgjykimit të quajtur “aktgjykim për shkak të mungesës.”²⁶ Gjykatat duhet që gjithmonë ti informojnë palët qartazi lidhur me pasoja e mundshme ligjore që mund të rezultojnë nga dështimi për tu përgjigjur në padi.²⁷

Seanca përgatitore siç është e paraparë me ligjin mbi procedurën kontestimore të vitit 2008, është një mjet i rëndësishëm, i cili po që se përdoret siç duhet nga gjykatat, mund të ngrit efikasitetin gjyqësor dhe të rezultojë në ngarkesë më të vogël me punë për resurset gjyqësore edhe ashtu të mbingarkuara në Kosovë.²⁸ Seancat përgatitore duhet të përdoren si ndihmë për të shmangur vonesat e panevojshme gjatë zhvillimit të procedurave.²⁹ Funkzioni parësor i seancës përgatitore është që të diskutohet lidhur me “propozimet e palëve dhe për faktet mbi të cilat mbështesin propozimet e tyre.”³⁰ Mbajtja e seancës përgatitor i lejon gjykatave të përcaktojnë se “çka do të jetë objekt shqyrtimi, [dhe] cilat prova do të merren, në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.”³¹

Megjithatë, OSBE ka vërejtur se gjykatat shpesh nuk përdorin siç duhet seancat përgatitore për të siguruar që të plotësohen të gjitha kushtet e domosdoshme për mbajtjen e shqyrtimit kryesor. Kjo praktikë mund të kontribuojë në vonesa të panevojshme në gjykimin përfundimtar të rasteve, që mund të jenë në shkelje të së

²⁶ Neni 151(1), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008 lejon lëshimin e aktgjykimit të tillë “me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare [...] po që se plotësohen këto kushte: (a) nëse i padituri është thirr rregullisht për në seancë; (b) nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë me anë të parashtresës; (c) nëse themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; (d) nëse faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht; (e) nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë.”

²⁷ Siç është dhënë më sipër në fusnotën 5.

²⁸ Gjykatat më tutje duhet të kenë parasysh se palët mund ta zgjedhin kontestin e tyre me anë të pajtimit gjyqësor në çfarëdo kohe gjatë gjykimit. Gjykata gjatë gjithë procedurës, e sidomos në seancën përgatitore, bënë të gjitha përpjekjet, por në mënyrën që nuk e rrezikon paanësinë e saj, për të zgjidhur kontestin me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes. Me qëllim që të kontribuojë në pajtimin gjyqësor gjykata mund t’ua bëjë palëve propozimin si të arrijnë pajtimin, duke i marrë parasysh dëshirat e palëve, natyrën e kontestit, raportet midis tyre si dhe rrethanat e tjera. Nenet 412-413, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008. OSBE më parë ka raportuar lidhur me implikimet negative mbi të drejtat e njeriut, për shkak të caktimit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve në gjykatat në Kosovë. Shih *Raport Mjor – qershor 2009: Numri i Pamjaftueshëm i Gjyqtarëve në Kosovë*, në http://www.osce.org/documents/mik/2009/09/39346_sq.pdf. E qasur me 1 qershor 2010.

²⁹ Komiteti i Ministrave nga Këshilli i Evropës ka theksuar se gjykatat duhen të kenë qasje pro-aktive në menaxhimin e proceduarve civile. Ka thënë se: “[g]jykatat duhet që, së paku gjatë dëgjimit preliminar por nëse është e mundshme edhe gjatë tërë procedurës, të luajnë rol aktiv në sigurimin e progresit të shpejtë të procedurës, duke respektuar të drejtat e palëve, përfshirë këtu edhe të drejtën e trajtimit të barabartë. Në veçanti duhet të ketë fuqi *proprio motu* (“në impuls të vetin”) ti urdhërojë palët që të ofrojnë sqarime të tilla që mund të jenë të domosdoshme, për ti urdhëruar palët që të paraqiten personalisht; të ngritin çështje lidhur ligjin; të kërkojnë dëshmi, së paku në ato raste kur ka interesa tjerë, përpos atyre të palëve në rast; të kenë kontroll mbi marrjen e dëshmimeve; të përjashtojnë dëshmitarët, deklaratat e të cilëve mund të jenë jo-relevante për rastin; të kufizojnë numrin e dëshmitarëve lidhur me ndonjë fakt të veçantë, kur një numër i tillë do të ishte i tepërt. Këto autorizime duhet të ushtrohen pa tejkaluar objektin e procedurës.” Parimi 4, Rekomandimi Nr. R(84)5E i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi *Parimet e Procedurës Civile të Projektuara për të Përmirësuar Funkcionimin e Gjyqësisë*, e dhënë më sipër në fusnotën 2.

³⁰ Neni 405, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

³¹ Neni 406(1), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

drejtës së palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme.³² Rasti më poshtë shërben si shembull.

Gjatë rigjykimit të një rasti lidhur me pronë, dëgjimi preliminar ishte mbajtur me 16 mars 2009 në një gjykatë komunale në rajonin e Prizrenit. Në dëgjimin preliminar, u lexua padia mbi të cilën bëri vërejtje përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit. Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit kërkoi nga gjykata që të ngrit vlerën e kontestit. Përfaqësuesi i paditësit u përgjigj se kundërshtimi i të padituri bazohej në ligjin mbi procedurën kontestimore të vitit 2008, përderisa rasti filloi në bazë të ligjit të mëparshëm mbi procedurën kontestimore. Andaj ai argumentoi se procedura duhet të zhvillohet sipas ligjit që ishte në fuqi kur filloi procedura.³³ Në fund të seancës përgatitore, duke caktuar datën 27 mars 2009 për shqyrtim kryesor, gjykata vendosi: “[p]alët janë të obliguara të prezantojnë çfarëdo dëshmi të mundshme, d.m.th. kundërshtim në kërkesëpadi, në shqyrtimin kryesor.” Megjithatë, kundërshtimet në kërkesëpadi duhet të bëhen nga fundi i seancës përgatitore, dhe duhet të jenë veçse të sqaruara kur procedura të hyjë në seancën e shqyrtimit kryesor.³⁴ Për më tepër, gjykata nuk adresoi gjatë seancës preliminare kërkesën e të paditurit për të qartësuar vlerën e kontestit, edhe pse është e obliguar ta bëjë këtë gjatë dëgjimit preliminar, bazuar në Nenin 36 të ligjit mbi procedurën kontestimore të viti 2008.³⁵

Në seancën përgatitore të mbajtur në rastin e përshkruar më lartë, gjykata nuk shfrytëzoi seancën për të kërkuar nga palët informacion shtesë apo sqarime lidhur me propozimet e tyre, e as nuk ka përcaktuar se cilat fakte do ti përdorin palët gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, për të dëshmuar propozimet e tyre. Në vend të kësaj, afati kohor i procedurës ishte vënë në rrezik pasi që çështjet që është dashur të zgjidhen gjatë seancës preliminare do të duhen të zgjidhen më vonë gjatë seancës së shqyrtimit kryesor. Duke pasur parasysh se kjo seancë përgatitore ishte mbajtur në rigjykimin e një rasti në të cilin padia fillestare ishte parashtruar me 16 maj 2006, gati tre vite më herët, roli pasiv i gjykatës në zhvillimin e procedurës në këtë rast është në veçanti shqetësues.

Seancat përgatitore nuk janë vetëm formalitet procedural, por ato janë një mekanizëm për gjykatat për të ushtruar në mënyrë aktive, kontroll mbi procedurën. Shfrytëzimi i duhur i procedurës përgatitore për të vlerësuar paditë dhe provat e palëve, mund të ndihmojë të eliminohet nevoja për të mbajtur seanca të mëvonshme plotësuese për ti siguruar këto kushte. Seancat plotësuese mund të çojnë në vonesa të panevojshme, në shkelje të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Duke siguruar të drejtën për gjykim brenda kohës së arsyeshme, KEDNJ “nënvizon rëndësinë e ndarjes së

³² Shih Nenin 6(1), KEDNJ.

³³ Megjithatë, Neni 532(1) i ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 2008 veçon se “ [n]ë qoftë se para hyrjes në fuqi të këtij ligji ka filluar të zhvillohet procesi gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, atëherë procedura e mëtuajtshme do të zhvillohet sipas dispozitave të këtij ligji.”

³⁴ Shih Nenet 256 dhe 403, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

³⁵ Neni 36, ligji mbi procedurën kontestimore i viti 2008 që thotë: “Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore [...], shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi.”

drejtësisë pa vonesa të cilat mund ta rrezikojnë efikasitetin dhe rëndësinë e saj.”³⁶ Vonesat e mëdha në procedura individuale po ashtu kontribuojnë në barrën edhe ashtu të madhe më lëndë civile në gjykatat e Kosovës.

OSBE më tej ka vërejtur se gjykatat ndonjëherë mbajnë seancat përgatitore madje edhe kur kushtet për të mbajtur këto seanca nuk plotësohen. Në kontekstin e gjyqësisë me resurse të pamjaftueshme në Kosovë, kur disa gjykata nuk janë në gjendje të mbajnë seancat në sallat e gjykimit për shkak të mungesës së hapësirës,³⁷ një praktikë e tillë përbën fatkeqësisht një harxhim jo të duhur të resurseve gjyqësore. Rastet më poshtë shërbejnë si shembuj:

Në një gjykatë komunale në rajonin e Pejë/Peć, paditësi parashtroi një kërkesë për anulimin e dy vendimeve të marra nga punëdhënësi i tij në kuptim të një kontesti për vendin e punës. Një vendim për fillimin e hetimeve ishte marrë po ashtu në lidhje me po të njëjtin rast. Gjykata mbajti seancën e parë preliminare me 29 shtator 2008. Në atë kohë, paditësi parashtroi provat e veta, dhe i padituri parashtroi kundërshtimet e tij lidhur me padinë. I padituri po ashtu propozoi që procedura civile të suspendohet për shkak të hetimeve penale që po kryheshin kundër paditësit. Gjykata me vendimin e vet refuzoi propozimin e të paditurit për suspendim të procedurës civile dhe ja përcolli kërkesën prokurorisë publike të qarkut që e njëjta t’ia ofrojë shkresat e lëndës dhe gjithashtu kërkoi dosjen nga Gjykata Supreme. Me 16 dhjetor 2008, gjykata mbajti një seancë tjetër preliminare, vetëm për ti informuar palët që gjykata ende nuk kishte pranuar shkresat nga prokuroria, të kërkuara në seancën e mëparshme preliminare, dhe shtyu seancën (seancën e shqyrtimit kryesor) për 26 shkurt 2009.

Në një rast të mbajtur pranë një gjykate komunale në rajonin e Prizrenit, një padi për alimentacion ishte parashtruar në nëntor të vitit 2006. Seanca e parë e rastit ishte mbajtur në dhjetor të vitit 2006, kur u konstatua se padia kurrë nuk ju kishte dërguar të paditurit, i cili po mungonte. Dëgjime u mbajtën përsëri në shtator 2007, dy herë në mars 2009, në prill 2009 dhe në shkurt të vitit 2010. Secila nga këto procedura ishte shtyrë për shkak të mos-paraqitjes së të paditurit. Gjykata mbajti secilën nga këto seanca pa ja dërguar padinë të paditurit, dhe pa verifikuar nëse i padituri ishte ftuar në mënyrë të rregullt para caktimit të seancave përkatëse. Edhe pse ka pasur indikacione se i padituri jeton jashtë vendit, gjykata kurrë nuk kërkoi shfrytëzimin e instrumenteve të përshtatshme ligjore³⁸ për të gjetur vendndodhjen e tij.

³⁶ *H. kundër. Francës*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 24 tetorit 1989, paragrafi 58.

³⁷ OSBE më parë ka nënvizuar përhapjen e kësaj praktike, dhe ka shprehur shqetësim lidhur me ndikimin që kjo ka mbi të drejtën për gjykim publik. Shih faqet 25-26 të raportit të OSBE-së, të publikuar në mars të vitit 2004, *Administrimi i Drejtësisë në Gjykatat Komunale në* http://www.osce.org/documents/mik/2004/03/2499_sq.pdf. E qasur me 1 qershor 2010

³⁸ Shih Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 2009/1-09 mbi procedurën e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale dhe civile, të datës 30 shtator 2009. Neni 1 rregullon procedurat e përfshira në procedimin e kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet civile dhe penale.

Përderisa OSBE më parë ka nënvizuar vështirësitë me të cilat përballen gjykatat për të ftuar palët,³⁹ gjykatat megjithëkëtë duhet që gjithmonë, para se të mbajnë seancën, të sigurojnë që kushtet për të mbajtur seancën janë përmbushur. Siç parashihet me ligjin mbi procedurën kontestimore të vitit 2008 “[s]eanca për shqyrtimin kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pa caktuar” dhe “nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.”⁴⁰ Gjykatat duhen që në mënyrë aktive të menaxhojnë procedurat duke kërkuar shfrytëzimin e procedurave të Ndhmës Juridike Ndërkombëtare kur kjo është e përshtatshme, dhe duke caktuar një përfaqësues të përkohshëm po që se dështojnë të gjitha përpjekjet e duhura për të mësuar vendndodhjen e të paditurit.⁴¹ Seanca përgatitore nuk është një forum i përshtatshëm për të konstatuar se a janë ftuar palët në mënyrë të rregullt.⁴²

Përfundim dhe rekomandime

Menaxhimi aktiv dhe efikas i procedurave civile kontestimore është thelbësor për sundimin e ligjit. Kur gjykatat në Kosovë dështojnë ti mbrojnë në mënyrë adekuate të drejtat e palëve gjatë administrimit të këtyre procedurave, zvogëlohet efikasiteti i sistemit gjyqësor si tërësi. Është e qartë se puna e gjykatave në Kosovë vështirësohet nga kufizime të mëdha logjistike. Megjithatë, menaxhimi i duhur i procedurave civile kontestimore në fazën përgatitore mund të ndihmojë që të eliminohet harxhimi i resurseve gjyqësore që shpesh ndodh kur gjykatat luajnë rol pasiv. Menaxhimi i duhur i fazës përgatitore po ashtu do të garantojë në mënyrë më efektive të drejtat e palëve të garantuara me KEDNJ, siç është e drejta për gjykim bazuar në parimin e kundërshtimit dhe e drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

Për gjykatat:

- Në procedurat civile kontestimore, gjykatat do të duhej që gjithmonë të ia dërgojnë të paditurit një kopje të padisë, brenda 15 ditëve nga kur ajo është parashtruar, bashkë me informacion të qartë lidhur me pasojat të mundshme për dështimin e përgjigjes ndaj padisë dhe dështimin për tu paraqitur personalisht në gjykatë.
- Gjykata do të duhej të përdorin procedurat përgatitore, siç është e paraparë me ligjin mbi procedurën kontestimore të vitit 2008 në mënyrë që të sigurojnë plotësimin e kushteve të domosdoshme për mbajtjen e shqyrtimit kryesor.
- Gjykatat do të duhej të mbajnë seanca përgatitore vetëm atëherë kur plotësohen kushtet për të mbajtur këto seanca.

³⁹ Shih faqet 14-15 të Shqyrtimit të parë të OSBE-së, *mbi Sistemin e Drejtësisë Civile* (qershor 2006) në http://www.osce.org/documents/mik/2006/06/19407_sq.pdf, e qasur me 1 qershor 2010.

⁴⁰ Neni 441(1), dhe 441 (2), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

⁴¹ Neni 79, ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008.

⁴² Pasojat e caktimit apo mbajtjes së seancës dëgjimore në të cilën palët nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt nuk parashihen në veçanti në ligjin mbi procedurën kontestimore të vitit 2008. Neni 123(1), ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 2008 parasheh që seancën e cakton gjykata “sa herë që një gjë të tillë e parashikon ligji ose kur kërkon procedura; Përkthimi zyrtar në anglisht i Nenit 123(3), thotë: “[g]jykata i thërret për pjesëmarrje në seancë palët dhe personat e tjerë, praninë e të cilëve e sheh të domosdoshme.” Megjithatë, versioni origjinal në gjuhën shqipe thotë krejtësisht diçka tjetër, që parasheh se kundër vendimit për caktimin e seancës nuk lejohet ankesa. Shih po ashtu Nenin 437(1) që thotë se gjykata mund ta shtyj seancën e caktuar “për shqyrtim kryesor para se të fillojë ajo, po që se konstaton se nuk janë plotësuar prezumimet ligjore për mbajtjen e saj, apo se provat e caktuara [sic] nuk do të mund të bëhen të pranishme deri në fillimin e seancës.”

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK):

- IGJK do të duhej të vazhdojë ofrimin e trajnimeve lidhur me procedurat përgatitore për gjyqtarët aktual dhe për kandidatët për funksione gjyqësore. Trajnimi do duhej të vë në dukje rolin e rëndësishëm që procedurat përgatitore luajnë në strategjinë gjithëpërfshirëse për menaxhim të rasteve.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK):

- KGJK do të duhej të vazhdojë trajnimin e personelit gjyqësor lidhur me përdorimin e duhur të procedurave përgatitore në rastet e kontestuara civile si mjet për përmirësimin e efikasitetit gjyqësor dhe sigurimin e menaxhimit efikas të rasteve.